

Kodi: 016/2- Kerkese per shoqerim nga sherbimet e policise rrugore te automjeteve qe transportojne ngarkese jashte norme/ngarkesa te rrezikshme

1. Baza Ligjore:

- a. Neni 10 ,11, neni 61 pika 5 dhe neni 62 i Ligji nr. 8378 datë 22.07.1998“*Kodi Rrugor i Republikës Shqipërisë*”(i ndryshuar) Neni 11 “Shërbimet e policisë rrugore dhe të kontrolleve të tjera në rrugë”
- b. V.K.M. nr.153, date 07.04.2000 Rregullore e zbatimi te kodit rrugor e cila perrcakton rregulla te hollesishme

2. Kriteret thelbësore dhe dokumentet shoqerues

Kriteret thelbësore	Dokumentet Shoqëruese (provuese dhe të tjera shoqëruese)
Kerkesa te identifikojë piken e nisjes, mbërritjes dhe intenerarin e veprimtarise dhe ta paraqiten te pakten 30 dite perpara dates te planifikuar te transportit	Pjese e formularit apo kerkese me shkrim nga organizatoret e veprimtarise
Transporti i ngarkeses te jete i autorizuar nga Autoriteti Rrugor Shqiptar	Autorizim nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, i cili jepet për një ose më shumë transportime ose për periudha të caktuara kohe në kufijtë e ngarkesës maksimale teknikisht të pranueshme. Në autorizim mund të përcaktohet intinerari, shoqërimi teknik si dhe <u>shoqërimi nga policia rrugore</u> .
Subjekti te jete i paisur me licencen perkatese sipas ligjit	Licenca perkatese e leshuar nga organi kompetent
Automjeti te plotesoje kushtet teknike per transportin e ngarkesave jashte norme	Dokumentet perkatese te automjetit
Drejtuesi i automojetit te jete i paisur me lejen perkatese te drejtimit qe lejon transportin e ngarkesave jashte norme.	Leja e drejtimit

3. Procedura/Njesite pergjegjese/afatet e ndermjetme

- a. Kerkesa dergohet, nga ZSHQ, ne Njesine Pergjegjese përfundimtare
- b. Njesia pergjegjese përfundimtare është Drejtoria e Policise Rrugore qe mbulon zonen nga behet nisja e veprimtarise.

- c. Drejtoria e Policise Rugore shqyrton plotesimin e kushteve dhe miraton apo refuzon kerkesen. Miratimi/refuzimi i njoftohet ZSHQ brenda 15 diteve nga paraqitja e kerkeses.
- 4. **Afati i Pergjithshem i Procedures (per njoftimin e kerkuesit):** 20 dite
- 5. **Afati i Vlefshmërisë:** vetem per tansportin e kerkuar
- 6. **Tarifa e procedures:** nuk ka
- 7. **Taksa/tarifa e veprimtarise:** per tu percaktuar (rekomandohet te behet me tarife/kilometer)